



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6285 Prot.

Ballsh më, 20.12.2022

VENDIM

Nr. 68, Datë 19 / 12 /2022

“PËR

**AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR OSE TË
AUTORIZUARIT PREJ TIJ PËR LIDHJE KONTRATE PARA NOTERIT PËR
SHITJEN E TRUALLIT TË OBJEKTIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.2, shkronja “a), neni 23, pika 14, neni 54, shkronja “k”, neni 55, pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjit nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, pika 4 e VKM nr. 329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak”, kërkesës me nr. 5755 Prot., datë 21.11.2022 “Kërkesë për lidhje kontrate për truallin e blerë nga Bashkia Ballsh, si dhe verifikimit të dokumentacionit të kryer nga ana e strukturave të Bashkisë Mallakastër,

VENDOSI

1. Miratimin e autorizimit të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër ose të autorizuarit ligjor prej tij për lidhje kontrate para noterit për shitjen e truallit për qytetarët si më poshtë:

Haxhi Cjapi

Pasuria nr. 8/57

sipërfaqe trualli 300 m2

ZK. 1090

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose i autorizuari prej tij për vazhdimin e procedurave për lidhjen e kontrates para noterit publik.

3. Ky vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

KRYETAR

FITIM BARAJ

